

Sek. për
Procedur, Etikën dhe Votimin



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË SOCIALISTE

Nr. 956 Prot.

Tiranë, më 03/03/2026

Lënda: Kërkesë për marrjen e masave disiplinore

Drejtuar: **Z. NIKO PELESHI**

KRYETAR I KUVENDIT TË SHQIPËRISË

SEKRETARIATIT PËR PROCEDURAT, VOTIMET DHE ETIKËN

Baza Ligjore: *Neni 63, neni 65 dhe neni 65/1 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë;*
Neni 6 të Kodit të Sjelljes së Deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

I nderuar zoti Kryetar i Kuvendit,

Seanca plenare e datës 2 mars 2026 është një seancë e cila i dedikohet shqyrtimit të çështjeve të evidentuara nga zgjedhësit. Kjo seancë është konceptuar për t'i dhënë të gjithë deputetëve mundësinë të paraqesin problematikat e zonës që përfaqësojnë, duke respektuar kohën e fjalës të përcaktuar në mënyrë të barabartë ndërmjet grupeve parlamentare dhe deputetëve jashtë grupeve parlamentare. Kjo seancë ka të përcaktuar 240 minuta dhe për deputetët jashtë grupeve parlamentare jepen 2 minuta.

Gjatë zhvillimit të seancës sipas listës së diskutantëve deputeti Agron Shehaj mori fjalën brenda minutazhit të parashikuar nga Rregullorja e Kuvendit. Megjithatë, pas përfundimit të kohës prej 2 minuta, deputeti Agron Shehaj nuk u largua nga foltorja, duke mbajtur të bllokuar foltoren e Kuvendit, në kundërshtim dhe në shkelje të Rregullores.

Në zbatim nenit 64 të Rregullore së Kuvendit, deputetit ju dha masa "Tërheqje e vëmendjes" pasi ai përdori gjuhë joparlamentare dhe me sjelljen e tij pengoi zhvillimin normal të seancës plenare.

Edhe pas kërkesës së bërë nga drejtuesja e seancës për të vijuar normalisht me rendin e ditës, deputeti Shehaj nuk u tërhoq nga shkeljet. Kështu që në mbështetje të nenit 64/1 të Rregullores së Kuvendit, deputeti cënoi rendin e seancës plenare dhe zptoi foltoren duke penguar deputetin e radhës të marrë fjalën, ai mori masën “Vërejtje”.

Në shkelje të Rregullores së Kuvendit, deputeti Shehaj vijoi të përdorë fjalë fyese dhe kundërshtuese ndaj drejtueses së seancës dhe më pas të agresonte verbalisht deputetë të Grupit Parlamentar të PS. Sipas përshkallëzimit të masave kur deputeti vijon sjelljen për të cilat është paralajmëruar atij i jepet masa “ Heqje e së drejtës se fjalës në seancë plenare”, masë e cila ju komunikua deputetit.

Edhe pas kërkesës për tu kthyer në normalitet, deputeti vijoi përsëri të pengonte zhvillimin e seancës plenare, duke mos lejuar deputetin e radhës të marrë fjalën dhe në këto kushte drejtuesja e seancës i komunikoi deputetit Agron Shehaj masën e përjashtimit nga seanca në zbatim të nenit 65 të Rregullores së Kuvendit.

Edhe pas marrjes së masës për tu përjashtuar nga seanca plenare dhe thirrjeve të përsëritura të drejtueses së seancës për të liruar sallën, deputeti refuzoi të dalë nga salla, duke shkaktuar kështu edhe bllokimin e vijimit normal të punimeve të Kuvendit dhe duke i pamundësuar 6 deputetëve fjalën e tyre në emër të zgjedhësve.

Për sa më sipër, ne një grup deputetësh të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, nisur nga marrja e të gjitha masave paraprake ndaj deputetit Agron Shehaj, në zbatim të Rregullores së Kuvendit, deputeti edhe pas tërheqjes së vëmendjes, dhënies së vërejtjes dhe përjashtimit nga seanca, pengoi zhvillimin e rregullt të seancës, shkaktoi kaos në sallë, fyerje dhe përdorim i një gjuhë joparlamentare ndaj drejtueses së seancës dhe ndaj deputetëve të PS, refuzoi të dalë nga salla plenare, sjellje këto të përsëritura prej tij, kërkojmë marrjen e masës “Përjashtim nga pjesëmarrja në seancë plenare dhe/ose komisione deri në 20 ditë”, e parashikuar në nenin 65/1 pikat 3 dhe 4 të Rregullores së Kuvendit.

DEPUTETËT :

1. Ejo Vllahi

2. Shidrina Zaxa

3. Arbaste Hime

4. Piro Thima

5. Besa Spaho

6. Admir Kadeli

7. Elza Buzi

8. Sara Mila

9. Zeqine Caushi

10. Gjergj Lumezi